

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR VITIN 2016

Kuvendi i Shqipërisë,

- Mbështetur në objektivat që udhëheqin veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë dhe masat e marra në përmbushjen e tyre;

- Duke vlerësuar kontributin që ka dhënë politika monetare në rritjen ekonomike të vendit;
- Duke u mbështetur në strategjinë afatmesme të zhvillimit të Bankës së Shqipërisë;
- Duke marrë në konsideratë ndikimin e zhvillimeve ekonomike kombëtare, rajonale e botërore në politikatat e ndjekura nga institucioni;

Vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë, për vitin 2016, në drejtim të:

- Lehtësimit të politikës monetare në funksion të objektivit të saj kryesor, ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, dhe kontributit të saj në reduktimin e kostos së financimit në të gjitha segmentet e tregut financiar;

- Harmonizimit të politikës fiskale konsoliduese me politikën monetare lehtësuese e stimuluese, për të arritur objektivin në treguesin e inflacionit;

- Përpjekjeve për rigjallërimin e kreditimit nëpërmjet reduktimit të kostove të financimit, përgatitjes së ligjit për falimentimin, përmirësimeve në ligjet për shërbimin përbarimor dhe Kodin e Procedurës Civile, zbatimit të masave kundërciklike, si dhe mbikëqyrjes së procesit të kredidhënies nga bankat e nivelit të dytë;

- Kontributit të politikës monetare në vijimësinë e qëndrueshmërisë së sistemit bankar, të shprehur në treguesit e shëndetit të veprimtarisë së sektorit bankar, siç janë kapitalizimi, likuiditeti dhe përfitueshmëria, të cilët janë mbi nivelin e treguesve rregullatorë përkatës;

- Konsolidimit të objektivit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe përafrimit të praktikave mbikëqyrëse me standardet europiane;

- Përpjekjeve për të nxitur përdorimin e instrumenteve të pagesave elektronike në vendin tonë, duke rishikuar kuadrin rregullator përkatës;

- Përmirësimit të administrimit të rrezikut operacional, nëpërmjet ngritjes së strukturës përkatëse dhe përmirësimit të kontrollit të brendshëm;

- Ndryshimeve të rëndësishme rregullatore në lidhje me aktivitetin e menaxhimit të fondeve logjistike në Bankën e Shqipërisë dhe informatizimit të veprimtarisë së CASH-it;

- Rishikimit të metodologjisë për vlerësimin e rezervave valutore në shërbim të rritjes së efikasitetit gjatë administrimit të fondit të rezervës valutore;

- Komunikimit të shpeshtë dhe transparent me publikun në funksion të zgjerimit dhe thellimit të kulturës financiare.

Kuvendi rekomandon që Banka e Shqipërisë për vitin 2017:

1. Banka e Shqipërisë duhet të vazhdojë të ndjekë politika që synojnë ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, si kusht për stabilitetin e përgjithshëm makroekonomik dhe për prime të reduktuara të rrezikut dhe të përpigjet në vazhdimësi për një harmonizim sa më të mirë të politikës monetare lehtësuese e stimuluese me politikën konsoliduese fiskale.

2. Mekanizmi i politikës monetare duhet të përmirësohet më tej nga Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me strukturat përkatëse qeveritare, për shkak të ndikimit që ai ka në arritjen e objektivit kryesor dhe në rritjen ekonomike të vendit.

3. Banka e Shqipërisë duhet të forcojë kontributin e saj në drejtim të rritjes së kreditimit të ekonomisë, i cili është faktori kyç për mbështetjen e veprimtarisë së biznesit dhe zgjerimin e rritjes ekonomike. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të cilësisë së kredidhënies, duke e orientuar atë drejt sektorëve strategjikë të ekonomisë së vendit.

4. Me synim reduktimin e nivelit të kredive me probleme, Banka e Shqipërisë duhet të forcojë mbikëqyrjen e bankave për parandalimin e krijimit të kredive të reja me probleme, përmirësimin e politikave dhe cilësisë së kreditimit, ristrukturimin e hershëm të kredive, si dhe hartimin dhe rishikimin e planeve, duke ruajtur nivelet e kuadrit rregullator në drejtim të provigjoneve dhe kapitalizimit.

5. Të rriten përpjekjet në drejtim të zgjidhjes së kredive me probleme për huamarrësit e mëdhenj të ekspozuar ndaj disa bankave dhe të rritet bashkëpunimi midis bankave për adresimin e problematikave të

kredimarrësve të përbashkët.

6. Banka e Shqipërisë duhet të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për të marrë masa në drejtim të reduktimit të nivelit të euroizimit në mënyrë graduale, për të siguruar uljen e ekspozimit të ekonomisë sonë ndaj këtij rreziku dhe rritjen e efektivitetit të politikës monetare.

7. Roli mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë duhet të forcohet më tej, në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar, adoptimit të standardeve ndërkombëtare, si dhe identifikimit e vlerësimit paraprak të rreziqeve, për të kufizuar ekspozimin e sektorit bankar ndaj rreziqeve të brendshme e të jashtme.

8. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, duhet të ndërmarrë nisma për të nxitur diversifikimin dhe thellimin e sistemit financiar në vend, duke u krijuar bankave dhe ndërmjetësuesve financiarë jobankarë mundësi të barabarta në treg, administrim më të shëndetshëm të rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të kredisë, si dhe mundësi më të mira financimi si periodikisht, ashtu edhe në raste të jashtëzakonshme.

9. Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me institucione të tjera, duhet të ndërmarrë nisma për nxitjen e tregjeve të kapitalit në nivel vendor, për të siguruar diversifikimin e burimeve të financimit për korporatat e mëdha, për të lehtësuar procesin e ristrukturimit financiar të tyre dhe për të nxitur financimin afatgjatë të tyre.

10. Banka e Shqipërisë duhet të zgjerojë e të forcojë bashkëpunimin me bankat e nivelit të dytë në drejtim të zbatimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor e rregullator. Në këtë kuadër, duhet të finalizohet puna për përmirësimin e ligjit për Bankën e Shqipërisë, në drejtim të rritjes së pavarësisë së institucionit dhe pasqyrimin të praktikave më të mira europiane.

Miratuar në datën 4.5.2017

KRYETARI
Ilir Meta